



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 13.11.2017

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, në mbledhjet e tij të zhvilluara në datë 6, 7, 8, 9 dhe 13 nëntor 2018.

Komisioni zhvilloi 9 seanca për shqyrtimin në parim të projektbuxhetit të vitit 2019 ku u njoh me projektbuxhetin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Komisioni u njoh me parashikimet e treguesit kryesorë të projektbuxhetit të vitit 2019 nga zv/Ministri i Financave z. Luçi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Projektbuxheti 2019 mbështet konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Ky projektbuxhet planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë.

Politikat e reja për projektbuxhetin 2019 lidhen kryesisht me:

- Rritjen e pagave në sektorët e shëndetësi, arsim parauniversitar, mbrojtje dhe sistemi penitenciar me një rritje prej 7%. Gjithashtu parashikohet dhe një rritje e pagës për punonjësit e përfaqësive diplomatike. Numri i përfituesve është 64 865 punonjës me një kosto prej 3 miliardë lekë në vit. Nga kjo rritje do përfitojnë 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë; 35,783 staf mësimor; 6,800 ushtarakë; 3,560 policë të burgjeve; 356 punonjës të përfaqësive diplomatike.
- Lehtësimin e barrës fiskale nëpërmjet uljes së normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm nga e cila përfitojnë, uljes së normës së tatimit mbi dividendin, uljes së normës së tatimit mbi fitimin me 2/3, uljes së taksave të ndryshme si ajo e ambalazheve. Gjithashtu parashikohet incentivimi i fermerëve, si dhe përjashtimet e parashikuara në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Përfituesit sipas këtyre ndërhyrjeve parashikohet të jenë rreth 15 mijë punëmarrës, 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit, 11 mijë biznese, 50 Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor, si dhe lehtësim të

veprimtarisë për qindra operatorë në industrinë e fasonit dhe ulje kostosh për operatorët që operojnë me ambalazhe.

- Shpërblimin për çdo lindje me synim përmirësimin e treguesit demografik të moshës mesatare të popullsisë nga e cila parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje.
- Vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë, si: Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Për Reformën Administrativo-Territoriale dhe reformat e decentralizimit financimi do të rritet me rreth 5 miliardë lekë ose 11% më shumë se sa ato të vitit 2018, të cilat do shkojnë për më shumë investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Ndër masat më të rëndësishme për këtë reformë mund të përmendim miratimin dhe zbatimin rigoroz të ligjit për financat e vetëqeverisjes vendore; dhe reformën për taksën e ndërtesave me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale.

Totali i të ardhurave për vitin 2019 është 486.477 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave bazohet në zgjerimin e bazës së tatueshme, luftën kundër informalitetit dhe përmirësimin e administrimit tatimor. Totali i shpenzimeve publike për vitin 2019 është planifikuar 519.4 miliardë lekë ose 29.6% e PBB. Me anë të këtyre shpenzimeve parashikohet të finalizojnë projektet e rrugëve nacionale, sektorin e ujit, shëndetësisë, arsimit dhe bujqësisë, si dhe zhvillimin rural.

Treguesit kryesorë të këtij projektbuxheti janë si më poshtë:

- Rritja ekonomike parashikohet në nivelin 4.3%;
- Norma e papunësisë parashikohet të ulet në 12%;
- Rënie të borxhit publik ndaj PBB-së;
- Investimet publike në masën 5% të PBB-së;
- Defiçiti buxhetor për vitin 2019 planifikohet në nivelin 1.9% të PBB-së;

1 – MINISTERIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në mbledhjen e datës 7 nëntor 2018. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Niko Peleshi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme sipas zërave më poshtë:

- **Zhvillimi Rural dhe Mëshetja për fermerin**

Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë, përmirësimi i standardeve si dhe garantimi i sigurisë ushqimore, mbetet qëllimi i programit i konceptuar përrealizim përmes këtyre objektivave:

- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe industrisë agro-ushqimore, si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale (nëpërmjet zbatimit të Skemës Kombëtare të mbështetjes së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural);

- Arritja graduale e standardeve të BE-së, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural (nëpërmjet zbatimit të Programit IPARD II);

- **Siguria Ushqimore**

Qëllimi i këtij programi është, fuqizimi i sistemit të kontrollit e inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë, dhe ka objektivat e mëposhtme:

- Kontrolli dhe monitorimi i sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla
- Forcimi i kontrollit të ushqimit, rrit garancinë e biznesit për cilësinë, sigurinë dhe standardin
- Përafrimi i legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian

- **Peshkimi**

Qëllimi i këtij programi është menaxhimi i peshkimit dhe akuakulturës duke mbështetur sektorin me politika strukturore për tregjet, politikat tregtare dhe politikat ndërkombëtare (EU, ICCAT, GFCM), me qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me standardet e BE-së, duke garantuar konkurueshmërinë e mbrojtjen e resurseve. Totali i programit 343 milion ose 22% më shumë se në vitin 2018.

- **Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit**

Për përmbushjen e prioriteteve strategjike për ujitjen në 360 000 ha tokë dhe garantimin e kullimit në 280 000 ha, për periudhën 2019-2021, synohet, jo vetëm kryerja e shërbimeve ekzistuese në vijim të atyre të vitit 2018, por dhe përmbushja (në progresivitet) e prioriteteve në lidhje me:

- rritjen e sipërfaqes të ujitur me gravitet, me qëllim sigurimin e ujitjes në çdo parcelë të tokës së punueshme,
- garantimin e kullimit me gravitet dhe ngritje mekanike (hidrovorë)
- rritjen e sigurisë së mbrojtjes nga pëmblytjet, çka rezulton me tejkalim të dukshëm të tavanëve buxhetore të parashikuara në PBA 2019-2021;

Mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, varet në një masë të konsiderueshme nga funksionimi i skemave kulluese (kanalet sekondarë) në administrim të bashkive, si dhe furnizimi me ujë për ujitje, të kanaleve sekondare në administrim të bashkive, që mbulojnë me ujitje rreth 120 000 ha.

- **Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor**

Qëllimi i këtij programi është përmirësimi i njohurive të fermerëve dhe agrobizneseve duke ofruar asistencë teknike falas me qëllim rritjen e prodhimit. Për realizimin e këtij qëllimi puna do të përqëndrohet në:

- Ofrimin e 45 kartave dhe paketave teknologjike me elementë të përmirësuar të cilat synohen të adaptohen dhe aplikohen prej rreth 60000 fermerëve;
- Informimin dhe asistimin e 270, 000 fermërëve nga strukturat e ekstensionit në 4 AREB;
- Trajnimin çdo vit të 229 specialistëve stafit të 4 AREB;
- Asistimin e rreth 12,600 fermerëve aplikues në skemat kombëtare dhe IPARD;
- Informimin dhe trajnimin e rreth 880 grave;

- Realizimin e 93450 mijë lekë të ardhurave nga aktivitetet dytësore të bazat prodhuese në 5 QTTB;
- Përmirësimin e kushteve të punës në 5 QTTB-të për realizimin e detyrave funksionale me cilësi dhe në kohë përmes projekteve të investimeve.

- **Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore**

Një nga ndikimet kryesore të rëndësishme të reformës konsolidimit të tokës do të jetë rritja e produktivitetit të prodhimit bujqësor për shkak të ekonomive të shkallës të krijuara si pasojë e rritjes së madhësisë së fermës. Rritja e prodhimit bujqësor do të rrisë konkurrencën në tregjet vendase dhe të huaja për këto produkte, gjë që do të ketë ndikim në rritjen e eksporteve, si dhe uljen e deficitit tregtar.

Reforma konsolidimit të tokës është një kompleks masash dhe në radhë të parë të krijimit të bazës ligjore dhe rregullimin e duhur lidhur fort me formalizimin e fermave bujqësore, si dhe aktivitetit të tyre ekonomik, që do të thotë rritje e aksesit në subvencione dhe kredi rurale nga fermerët dhe agrobizneset. Përveç kësaj, do të rrisë investimet në bujqësi dhe zhvillimin e tregut formal të tokës.

Diskutimet u përqëndruan kryesisht në funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit; në funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët; në kontrollin e farërave; në mbështetjen e inputeve bujqësore me heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar për to; në forcimin e kontrollit për sigurinë ushqimore në të gjitha aspektet e saj dhe forcimin e institucioneve që lidhen me të. Shqetësim vazhdon të mbetet çështja e statistikave në bujqësi në mënyrë që të hartohen politikat e duhura, si dhe formalizimi i fermerëve që të mundësohet përfitimi nga skemat mbështetëse.

Gjithashtu, deputetët kërkuar që të adresohet çështja e statusit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare ISUV duke mundësuar kthimin e statusit të një Instituti Kërkimor – Shkencor me qëllim ruajtjen dhe rikthimin e kapaciteteve shkencore në atë institut për shkak të rëndësisë së veçantë që ka në lidhje me mirëqenien e popullatës.

- **Kërkesa**

Gjatë prezantimit, Ministri kërkoi mbështetjen e Komisionit për disa ndryshime në buxhet të cilat lidhen me:

1. Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për objektet e mbrojtjes nga përmbytja, për zonat me të rrezikuara, sidomos në lumenjtë Vjosë, Drinos, Osum, Shkumbin, Buna, ku janë dhe zonat me të dëmtuara nga përmbytjet e dhjetorit 2017-ës dhe shkurtit të 2018-ës.
2. Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për AZHBR-në, pasi kjo mungesë fondesh cënon aktivitetin e saj, duke pasur parasysh ngarkesën e kësaj të fundit edhe me skemat IPARD. AZHBR për vitin 2019 është e ngarkuar edhe me zbatimin e Programit IPARD II dhe Programit për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve, pra do të ketë ngarkesë më të madhe pune se vitet e tjera dhe do të duhet të kryej më shumë kontrolle në terren, si pasojë, nevojiten më shumë shpenzime operative për stafin e angazhuar në këtë proces, staf i rritur me 36 punonjës.
3. Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për programin për Sigurinë Ushqimore, pasi niveli i akorduar nuk plotëson kërkesat e reja shtesë që kanë ardhur si pasojë e kërkesave të ardhura nga 2 misionet e auditit të KE-së. Këto kërkesa janë të lidhura me

analizimin në ISUV ose në laboratorë të tjerë të akredituar brenda ose jashtë vendit, të dy planeve të monitorimit për produktet e peshkut dhe të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore. Moskryerja e këtyre analizave rrezikon mbylljen e eksporteve me vendet e BE-së. Nga ana tjetër moskryerja e analizave të mbetjeve në fruta dhe perime, rrezikon eksportin në tregun ndërkombëtar.

4. Gjithashtu, nga kjo ministri u kërkua edhe mundësimi i heqjes së TVSH-së për inputet bujqësore, por pa hequr TVSH-në e rimbursueshme për fermerët sipas skemës për mbështetjejeje e fermerëve.

3- MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mbledhjen e datës 7 nëntor 2018. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Damian Gjijnuri dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Projektbuxheti i vitit 2019 në sektorin e infrastrukturës dhe energjisë parashikon një financim total prej 50.88 miliardë lekë. Për sa i përket mbështetjejeje në infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësa në krahasim me atë të vitit 2018 ka një rritje të investimeve në këtë buxhet me 2.7%. Me këtë buxhet bëhet e mundur hapja e disa projekteve të reja, mbyllja e projekteve të nisur.

Orientimet kryesore të buxhetit 2019 të MIE janë:

1. Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare si: vazhdimi i segmenteve të ndërtimit të rrugëve prej 2018 dhe ndërtime të segmenteve të reja, rehabilitimi dhe sistemimi i rrugëve kombëtare me kontrata që përfundojnë në 2018 por zbatohen në 2019-2020, praktika e re e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
2. Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: një portofoli të investimeve publike dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
3. Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë sipas shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, tërheqjes së teknologjive të avancuara, rritjen e peshës së gjenerimit të energjisë së rinovueshme;
4. Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, si: vazhdimi i ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta, dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese.

Ky buxhet synon të përmbushë objektivat e mëposhtme sipas fushave:

- **Energjia**

Mbështetja për energjinë do të vazhdojë edhe këtë vit. Janë lançuar programe të ndryshme të diversifikimit përfshirë edhe burime të tjera alternative të energjisë.

Në këtë program një peshë të rëndësishme zë detyrimi për rimbursimin e kostos së infrastrukturës zëvendësuese të Devoll Hidropower.

Gjithashtu, është krijuar Agjencia për Efikasitetin e Energjisë si institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efikasitetin e energjisë.

- **Infrastruktura**

Fokusi i investimeve do të jetë në akset kryesore kombëtare. Buxheti do të bëjë të mundur hapjen e disa kantierëve të reja shumë të rëndësishme për lidhjet, nyjet kryesore të transportit rrugor, siç është edhe mundësia për vazhdimin e një pjese të unazës, sidomos nyja që lidh nga ish-fabrika e birrës, pra nyja që lidhet me pjesën e unazës së sapopërfunduar me sheshin Shqiponja.

Për ndërtime (investime) dhe mirëmbajtje në vitin 2019 buxheti i brendshëm është 16.18 miliard lekë (2 lote dhe vijim i investimeve nga 2018) duke përfshirë edhe 4.1 miliard lekë (fillimi pagesave për investimet me PPP). Ndërsa buxheti me fonde të huaja është 8.3 miliard lekë.

Për vitin 2019 është parashikuar hapja e projekteve të reja:

- Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi te sheshi “Shqiponja”.
- Qafë Qelë – Fushë-Arrëz.
- Jorgucat - Sarandë.
- Llogara – Sarandë.
- Librazhd – Qafë Stude. Shtesë kontrate. Loti 3

- **Mbetjet urbane**

Mbetjet urbane mbeten një nga sfidat e mëdha që ka vendi përsa i përket trajtimit të tyre dhe do të jetë një sfidë e vazhdueshme e shoqërisë shqiptare edhe në të ardhmen për shkak të kostove të saj.

Për vitin 2019 pritshmëritë janë:

1. Vazhdimi i financimit të huaj për projektin “Sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve për Qarkun Vlorë”, si dhe dhe financimi i brendshëm i TVSH-së dhe kostos lokale të këtij projekti.
2. Përfundimi i financimit të huaj për studimin e fizibilitetit dhe masa shoqëruese për projektin “Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Qarkun e Beratit”, si dhe financimi i brendshëm i TVSH-së për këtë projekt.
3. Vazhdimi i financimit të brendshëm të projektit “Faza e dytë e projektit të ndërtimit të venddepozitimit në Bushat”.
4. Fillimi i financimit të brendshëm të projektit “Mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta, Durres”.
5. Vazhdimi i financimit të brendshëm sipas kontratave për projektet e Inceneratorëve të Fierit dhe Elbasanit.
6. Fillimi i financimit të huaj për projektin “Administrimi i mbetjeve të ngurta në Juglindje të Shqipërisë, faza e dytë, masa shoqëruese”, si dhe financimi i brendshëm i TVSH-së të këtij projekti.
7. Fillimi i punimeve për projektin “Qëndrueshmëria financiare e sektorit të mbetjeve urbane dhe orientimi drejt performancës”, me financim të brendshëm.

- **Furnizim me ujë dhe kanalizime**

Në hartimin e politikave të reja janë marrë në konsideratë 2 objektivat kombëtare si angazhimi kryesor i MIE në sektorin e ujit për 3 vitet në vazhdim:

- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar deri në masën 20%;

- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë/ditë.

Në vitin 2019 do të financohen të gjithë objektet me kontrata të lidhura më parë, me përjashtim të 6 objekteve që mbeten për financin në vitin 2020, si dhe gjatë vitit 2019 do të çelen edhe 2 objekte të reja që janë:

- “Mbështetje teknike në zbatim të reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve (sipas performancës , për uljen e humbjeve deri në nivelin teknik 20% dhe matjen e prodhimit të ujit);
- “Përmirësimi i infrastrukturës së ujrave të zeza në zonën bregdetare Vlorë”;
- “Programi i Infrastrukturës Bashkiake III dhe IV” me financim të KfE-së.

Diskutimet u përqëndruan në gjendjen aktuale të infrastrukturës rrugore e standardet e saj, si dhe në projekte të veçanta të saj; zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore; menaxhimi i mbetjeve urbanedhe problematikat e tyre si në grumbullim, venddepozitime apo incineratorë; problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujësjellës – kanalizime; investimet në sektorin e energjisë; aeroportet e Kukësit dhe Vlorës që pritet të ndërtohen; etj.

4- MINISTERIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mbledhjen e datës 9 nëntor 2018. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri z. Blendi Klosi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2019 do të jetë rreth 2.63 miliardë lekë dhe në tërësinë e tij, shënon një rritje krahasuar me një vit më parë.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme si:

- **Zhvillimi i turizmit**

Turizmi ka gjeneruar rreth 2 miliardë eru në buxhetin e shtetit për vitin 2018. Mbështetja buxhetore që merr turizmi në këtë buxhet është më e lartë se ajo e vitit aktual përse i përket investimeve. Ky sektor ka pasur rritje të madhe dhe si i tillë ka vëmendje të shtuar në projektbuxhetin 2019 e reflektuar në investime direkte që lidhen me:

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor;
- Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve pritëse, vendosja e sinjalistikës turistike në destinacionet e agroturizmit përfshirë 100 fshatrat;
- Marketingun e destinacionit turistik shqiptar;
- Hartimin e planeve të menaxhimit turistik të zonave me përparësi turizmin;
- Përgatitjen e hartave dhe të filizofisë së krijimit të zonave të mbrojtura apo të zonave që konsiderohen si zona me potencial për t’u shndërruar në në zona të mbrojtura natyrore; etj

Gjithashtu, parashikohen investime në politikat që lidhen me shndërrimin e Shqipërisë në një destinacion turistik alternative. Ndërkohë që investimet në infrastrukturë rrugore e aeroportuale, në ujësjellës – kanalizime, në mjedis, në rritjen e kapaciteteve nga shkollat e edukimit profesional, etj janë një mbështetje direkte e këtij sektori.

Financimet e brendshme për vitin 2019 për programin “Zhvillimi i Turizmit” janë rreth 322 milionë lekë.

- **Mjedisi**

Mjedisi është pjesë e rëndësishme e Minsitrisë. Prioritet vazhdojnë të mbeten programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij. Në kuadër të politikave të *Clean & Green 2020*, janë përcaktuar disa fusha për një qasje të re ndaj mjedisit. Koncretisht ka një filozofi të re për trajtimin e guroreve, pikave të grumbullimit të skrapit, makinave të importuara, përdorimit të qeseve plastike, venddepozitimeve të mbetjeve urbane, etj. Për sa i përket venddepozitimeve të mbetjeve urbane është përgatitur harta e re e venddepozitimeve formale dhe informale.

Objektivat për mjedisin fokusohen në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit urban; monitorimi i cilësisë së ujërave; hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit në mbrojtjen e mjedisit dhe të natyrës në kuadrin ligjor të Bashkimit Europian; edukimin e brezave të rinj me kujdesin ndaj mjedisit dhe minimizimin e ndotjeve; asistimin në ngritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor në rolin e tij për ruajtjen e mjedisit; nxitja e partneritetit publik privat; integrimi i ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave dhe bujqësisë, zhvillimit urban dhe infrastrukturës; mbrojtja, fuqizimi dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura; hartimi i inventarit të parë kombëtar të pyjeve; regjistrimi kadastral kombëtar; pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara; zbatimi i skemës së granteve konkurruese; hartimi i ideologjisë në sektorin e karbonit; mbrojtja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe biodiversitetit; hartimi i planit për pastrimin e Shqipërisë për të përcaktuar qartazi se kush janë ndotësit; etj.

Diskutimet në Komision u përqëndruan kryesisht tek mbrojtja e mjedisit; monitorimi i veprimtarive ekonomike që shkaktojnë ndotje të ajrit e mjedisit në përgjithësi; monitorimi i saktë i zonave bregdetare; ecuria e administrimit të pyjeve dhe fondet e akorduara për to; iniciativat ligjore për një legjislacion të ri për pyjet; procesi i menaxhimit të mbetjeve dhe format që kanë prioritet në këtë proces sipas politikave të ministrisë; incentivat për zhvillimin e turizmit e vecanërisht për ato që lidhen me agroturizmin; projektin e 100 fshatrave; investimet në turizëm dhe ecuria e këtij sektori; etj.

Kërkesë

Gjatë prezantimit të buxhetit 2019 ministri Klosi kërkoi fonde shtesë për të mbështetur eliminimin e venddepozitimeve informale të mbetjeve urbane.

5. FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në mbledhjen e datës 8 nëntor 2018. Projektbuxheti i FSHZH-së u paraqit nga Drejtori z. Beci dhe përfaqësues të tjerë të këtij institucioni.

Investimet nga financimi i huaj shkojnë në 5.87 miliardë lekë ndërsa me financim të brendshëm në 10.5 miliardë lekë. Buxheti i vitit 2019 për këtë institucion është në të njëjtën linjë me atë të viteve të mëparshme. Projektet e FSHZH-së gjithnjë e më tepër po shkojnë drejt projekteve të integruara me një pikësynim drejt zhvillimit ekonomik të zonave ky zhvillohet projekti. Z. Beci bëri një përshkrim të shkurtër të projekteve që mbulon FSHZH-ja për vitin 2019.

Diskutimet në Komision u përqëndruan në akse rrugore të ndryshme; standardet e rrugëve; në ujësjellës të zonave të ndryshme; dhe projektet e Alpeve dhe atë të 100 fshatrave.

6- GRUPE INTERESI

Gjatë shqyrtimit të buxhetit 2019 dhe paketës fiskale, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të disa grupeve të interesit si më poshtë:

- **Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA)**

Ky grup shprehu shqetësimin e tij në lidhje me vendosjen e akcizës prej 1 lekë/kg për zhavorrin bituminoz duke argumentuar që kjo përbën rreth 32% të çmimit të produktit dhe kjo rritje do të bëjë që fabrikat e çimentove që janë përdorues të zhavorrit bituminoz të drejtohen drejt produkteve të tjera siç është koxhi i naftës, si dhe do të çojë drejt mbylljes bizneseve që operojnë në karrierat e Selenicës.

Gjithashtu, shprehën shqetësim për rritjen e akcizës së kromit nga 6 në 9%. Duke qenë se kapaciteti përpunues në vend është i kufizuar, kjo bën që tepricat t'i drejtohen importit duke u bërë kështu subjekt i një akcizës prej 9%. Sipas Shoqatës kjo do të bëjë që të ulët sasia e nxjerrjes së kromit duke penalizuar më shumë subjektet e vogla të nxjerrjes së kromit.

- **Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas**

Për shëndoshjen e situatës financiare të bizneseve dhe njëkohësisht edhe për rritjen e cilësisë së shërbimit përfaqësuesit e kësaj shoqate propozuan që në paketën fiskale të vitit 2019 të reflektohen masat si më poshtë:

- Të vihet në lëvizje vendimmarrja e Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për kompensimin e shpenzimeve të transportit urban për kategoritë e qytetarëve me status të veçantë dhe studentëve.
- Reduktimi i TVSH-së deri në 10%. Vetëm po të reduktohet TVSH, nga 20% në 10%, efekti në buxhetin e shtetit neto llogaritet në rreth 224 milion lekë, për gjithë shërbimin e transportit qytetas të vendit.
- Heqja e Akcizës ose taksës së qarkullimit për karburantin e përdorur në këtë shërbim. Nëse do të hiqet akciza efekti neto në buxhetin e shtetit llogaritet në rreth 280 milion lekë, ndërsa po të hiqet taksë e qarkullimit efekti në buxhetin e shtetit llogaritet në rreth 250 milion lekë.
- Të njihet si e zbritshme e gjithë vlera e TVSH-së së paguar për blerjen e karburantit.

- **Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë**

Disa nga propozimet e tyre lidhen me ligje të ndryshme financiare janë si më poshtë:

- Me qëllim garantimin e zbatimit të parimeve kushtetuese në vendosjen e Taksave, por gjithashtu për të shmangur ekspozimin e paparashikueshëm dhe të pajustificuar financiar të operatorëve të biznesit, Ligji duhet të përcaktojë qartësisht dhe Këshillat Bashkiakë duhet të përcaktojnë dhe parashikojnë qartësisht në vendimet e tyre, gjatë vendosjes së taksave të tilla të përkohshme, me arsyetimin e mjaftueshëm mbi çështjet:
 - të specifikohet kur Këshillat Bashkiakë kanë të drejtë të aplikojnë këto taksa;
 - nevojat përkatëse të komuniteteve për përfitimin e të cilëve aplikohen këto taksa;

- kushtet dhe kriteret për llogaritjen dhe implementimin e këtyre taksave.
- Në vendet e BE-së, u japin Shoqërive një periudhë të pacaktuar kohore për shfrytëzimin e humbjeve tatimore të krijuara gjatë 3 viteve të para të investimit, në këtë drejtim, si dhe me qëllim krijimin e një mjedisi tërheqës për investimet e huaja direkte që kryejnë investime *Greenfield*, rekomandohet së tepërmi që periudha 3 vjeçare e përcaktuar në ligjin “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të zgjatet minimalisht 10 vjet.
- Të barazohet vlera e taksës së truallit për qëllime biznesit me vlerën e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët.
- Të hiqen taksat doganore për artikujt që janë lëndë e parë për industrinë prodhuese.
- **Shoqata e Ricikluesve**

Shoqata e ricikluesve shprehu shqetësimin e saj në lidhje me taksën e ambalazhit dhe të lëndës së parë të granular plastike. Ata u shprehën që biznesi i tyre rëndohet dy herë tashmë prej kësaj takse, konkretisht me taksën e lëndës së parë prej 25lekë/kg, si dhe me taksën e ambalazheve dhe produkteve që prodhojnë me të dhe eksportojnë.

Gjithashtu, kërkuan reduktimin e taksës së lëndës së parë nga 25 lekë/kg në 10 lekë/kg.

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2019 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2019

Dokument parlamentar

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”**

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” Komisioni zhvilloi 9 seanca ku u njoh me projektbuxhetin e vitit 2019 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Komisioni u njoh me kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila ka identifikuar kërkesa shtesë për financim, duke mbështetur prioritetet si më poshtë:

- Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për AZHBR-në, pasi kjo mungesë fondesh cënon aktivitetin e saj, duke pasur parasysh ngarkesën e kësaj të fundit edhe me skemat IPARD. AZHBR për vitin 2019 është e ngarkuar edhe me zbatimin e Programit IPARD II dhe Programit për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve, pra do të ketë ngarkesë më të madhe pune se vitet e tjera dhe do të duhet të kryej më shumë kontrolle në terren, si pasojë, nevojiten më shumë shpenzime operative për stafin e angazhuar në këtë proces, staf i rritur me 36 punonjës.
- Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për programin për Sigurinë Ushqimore, pasi niveli i akorduar nuk plotëson kërkesat e reja shtesë që kanë ardhur si pasojë e kërkesave të ardhura nga 2 misionet e auditit të KE-së. Këto kërkesa janë të lidhura me analizimin në ISUV ose në laboratorë të tjerë të akredituar brenda ose jashtë vendit, të dy planeve të monitorimit për produktet e peshkut dhe të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore. Moskryerja e këtyre analizave rrezikon mbylljen e eksporteve me vendet e BE-së. Nga ana tjetër moskryerja e analizave të mbetjeve në fruta dhe perime, rrezikon eksportin në tregun ndërkombëtar.
- Shtesë fondesh me 100 milionë lekë për financimin e brendshëm për vitin 2019 për objektet e mbrojtjes nga përmytja, për zonat me të rrezikuara, sidomos në lumenjtë Vjosë, Drinos, Osum, Shkumbin, Buna, ku janë dhe zonat me të dëmtuara nga përmytjet e dhjetorit 2017-ës dhe shkurtit të 2018-ës.

Pasi i diskutoi kërkesat e mësipërme, Komisioni vendosi t’i marrë në konsideratë pjesërisht ato, duke pranuar vetëm shtesat për dy kërkesat e para, por edhe këto duke i siguruar nga ulja në programin

“Zhvillimi rural” në fondin për buxhetet familjare dhe individët. Konkretisht, Komisioni i sugjeron komisionit përgjegjës të vlerësojë propozimet si më poshtë:

1. Në programin “Zhvillimi Rural” 04250, artikulli 602 (mallra dhe shërbime) të shtohet me 100 milionë lekë.
2. Në programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” 04220, artikulli 602 (mallra dhe shërbime) të shtohet me 100 milionë lekë.
3. Në programin “Zhvillimi rural” 04250 artikulli 606 (transferta për buxhetet familjare dhe individët) të pakësohet me 200 milionë lekë.
4. Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Bankës Botërore, shtesë fondi prej:
 - 1,478 milionë lekë financim i huaj Kap. 2 , artikull 231 dhe
 - 470 milionë lekë financim i brendshëm kap. 4, artikull 231(TVSH),

kjo bazuar në kushtet e Marrëveshjes së Kredisë, e ratifikuar sipas Ligjit 31/ 2018 “ Për ratifikimin e marrëveshjes me IBRD”, bazuar në faktin se punimet civile për 7 skemat ujitëse pritet të përfundojnë në fund të vitit 2019. Palnifikimi i financimit në buxhetin e vitit 2019 përfaqëson një detyrim të paarshikuar në marrëveshjet ndërkombëtare.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, vendosi me shumicë votash mbështetjen e kërkesave të mësipërme dhe miratimin nën nën të projekligjit “Për buxhetin e vitit 2019”. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në votim.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar